KOMUNA E PODUJEVËS

# NJOFTIM PËR KONTRATË

☒ ***PUNË*** ☐ ***FURNIZIM*** ☐ ***SHËRBIME***

*Sipas Nenit 40të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

**Data e përgatitjes së njoftimit: 08.09.2025**

| | |
|---|---|
| **Nr i Prokurimit** | **615-25-7844-5-1-1** |
| **Nr i brendshëm** | |

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip ☒ Serbisht ☒ Anglisht ☒

## NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

### I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

| | | |
|---|---|---|
| **Emri zyrtar**: **KOMUNA E PODUJEVËS** | | |
| **Adresa Postare**: **RR.ZAHIR PAJAZITI** | | |
| Qyteti: **PODUJEVË** | Kodi postar: **-** | Vendi: **Kosovë** |
| **Personi kontaktues**: **Bashkim Ibrahimi**<br>**Ganimete Mahmuti** | Telefoni: **+383 20041021** | |
| Email: **prokurimi.podujeva@rks-gov.net** | Faksi: | |
| Adresa e Internetit (*nëse aplikohet*): | | |

Po ☐ Jo ☒

Kontrata përshinë prokurimin e përbashkët

Po ☐ Jo ☒

Kontrata shpërblehet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit

***Nëse po***, specifiko identitetin e të gjithë Autoriteteve Kontraktuese që kanë të drejtë të bëjnë porosi nën termet e kontratës ose referoju një Aneksi:

## NENI II: LËNDA E KONTRATËS

## II.1) PËRSHKRIMI

**II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:**
**Riasfaltimi dhe rikonstruimi me infrastrukturë përcjellëse i rrugës Podujevë-Letanc**

**II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit**
*(Zgjidhni vetëm një kategori - punë, furnizime apo shërbime – e cila korrespondon më së shumti me objektin specifik të kontratës suaj)*

| ☒ **Punë** | ☐ **Furnizime** | ☐ **Shërbime** |
|---|---|---|
| ☒ Ekzekutim<br>☐ Plani dhe ekzekutimi<br>☐ Realizimi, në çfarëdo mënyre, të punës, përgjegjës me kërkesa | ☐ Blerja<br>☐ Qira financiare (lizing)<br>☐ Qira<br>☐ Blerje me këste<br>☐ Një kombinim i këtyre | |

Vendi apo vendndodhja kryesore e punëve/kryesor i dorëzimit/ kryesor i realizimit
**Podujevë-Letanc**

**II.1.3) Njoftimi përfshinë**

Krijimin e kontratës publike kornizë
☐

**II.1.4) Informacionet e marrëveshjes kornizë** *(nëse aplikohet):*

Kontrate publike kornizë me një operator
☐

Kontrate publike kornizë me disa operator
☐

**Ekzekutimi i kontratës:**

Thirrje/Porosi
☐

Kontrata ndihmëse/Mini-konkurencë
☐

**Kohëzgjatja e kontratës publike kornizë: në muaj**

**II.1.5) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës**
**Riasfaltimi dhe rikonstruimi me infrastrukturë përcjellëse i rrugës Podujevë-Letanc L2000m**

**II.1.6) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP):**

45000000-7

**II.1.7) Variantet pranohen**

**Po** ☐ **Jo** ☒

**II.1.8) Ndarja në Pjesë**

**Po** ☐ **Jo** ☒

***Nëse po,*** tenderët mund të dorëzohen për *(shënoni vetëm një kuti)*

☐ vetëm një pjesë ☐ Të gjitha pjesët

**II.1.9) Informacione lidhur me pjesët** (*nëse aplikohen)*

| Nr. i pjesës | Emërtimi i grupit | Përshkrimi i shkurtër |
|---|---|---|
| | | |

**Numri maksimal i Pjesëveqë do të mund të shpërblehet tek një tenderues është:**

**II.1.10) Vlera e parashikuar e kontratës: 799,909.44**

**II.2) SASIA APO FUSHËVEPRIMI I KONTRATËS**

**Sasia apo fushëveprimi i përgjithshëm** *(përfshirë të gjitha pjesët dhe opsionet nëse aplikohen)*
**L-2000m**

**II.3) KOHËZGJATJA E KONTRATËS APO AFATET KOHORE PËR PËRFUNDIM**

Kohëzgjatja në muaj **26** apo ditë (nga dhënia e kontratës)
*apo*
Fillimi
Përfundimi

**NENI III: INFORMACIONET LIGJORE, EKONOMIKE, FINANCIARE DHE TEKNIKE**

**III.1) KUSHTET NË LIDHJE ME KONTRATËN**

**III.1.1) Siguria e kërkuar e ekzekutimit**

**Po** ☒ **Jo** ☐

***Nëse po***, vlera e sigurisë së ekzekutimit EUR ose **10%** % e vlerës së kontratës

**III.1.2) Forma ligjore që do të merret përmes grupit të operatorëve ekonomik të cilëve do t`u jepet kontrata** *(nëse aplikohet)*:

**III.1.3) Kushtet e tjera të veçanta me të cilat ka të bëjë ekzekutimi i kontratës**

**Po** ☒ **Jo** ☐

***Nëse po,*** përshkrimi i kushteve të veçanta

| |
|---|
| Autoriteti Kontraktues do ta bëjë pagesen e paradhenies kontraktuesit ne baze te ligjit 08 L-332 për Buxhetin e Republikes se Kosoves per vitin 2025 nenin 13.1 nga data e caktuar e menaxherit te projektit kunder dispozites nga kontraktuesi i një garancioni te pakushtezuar Bankar ne nje forme te pranueshme per autortitetin kontraktues ne sasi dhe valutë te barabartë me parapagim. Garancia do te mbetet ne fuqi deri sa te behet pagesa e pare, por shuma e garancise duhet te reduktohet ne menyre progresive nga shuma qe paguhet nga kontraktuesi. Interesi nuk do te paguhet per parapagim. Kontraktuesi do te perdorë parapagimin vetëm për te paguar Paisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera te nevojshme posaqerisht per kryrejen e punëve. Kontraktuesi duhet te deshmoj se pagesa paradhenie eshte perdorur ne kete menyre me furnizim te kopjeve te para faturave ose dokumenteve te tjera per menaxherin e projektit. Parapagimi do të paguhet duke zbritur shumen proporcinale nga pagesat per shkak te kontraktuesit, pas orarit te perqindjeve te perfunduara te puneve ne baze te pageses. |

## III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

| III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë: | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:* |
|---|---|
| Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit nr. 04 L-042 (Versioni i Konsoliduar). Plotësimi i Aneksit Nr. 2 të Dosjes së Tenderit | Kjo kërkesë duhet të përmbushet me dorëzimin e dokumenteve të mëposhtme 1. Deklaratën nën Betim nga tenderuesi se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë Neni 65 i Ligjit Nr. 04 L-042, duke përdorur dhe plotesuar formën e përcaktuar ne dosjen e tenderit – Aneksi 2 te dosjes se tenderit. 2. Vërtetim (dokument përkatës) nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit te operatorit ekonomik, se operatori ekonomik ne fjalë nuk është në vonesë për pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorezimit te tenderit - datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës. 3. Vërtetim te lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori i tillë ekonomik, ndonjë drejtues,menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluara nuk janë shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale ose civile duke përfshirë praktikat e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme, vepre penale serioze të pjesëmarrjes në aktivitetet e një organizate kriminale, për mashtrim apo një akt të ngjashëm me mashtrim – të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit të vitit që menjëherë paraprinë datën e publikimit të njoftimit të kontratës. 4. Vërtetim te lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik nuk është ne falimentim ose nën administrim te dhunshëm gjyqësor - të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit të vitit vitit që menjëherë paraprinë datën e publikimit të njoftimit të kontratës. Shënim Dokumentet e kërkuara nën pikën 2,3 dhe 4 duhet të dorëzohen të skanuara nga origjinali nga operatori ekonomik që propozohet për dhënie të kontratës, dhe duhet |

| | |
|---|---|
| | të dërgohen te Autoriteti Kontraktues brenda afatit të kërkuar para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Dështimi për të paraqitur një nga këto dokumente brenda afatit kohor, do të thotë që tenderuesi i propozuar për dhënie të kontratës do të refuzohet, do të konfiskohet sigurimi i tenderit nëse është kërkuar, inicohet procedura për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP, dhe Autoritetit Kontraktues do të vazhdojë tenderuesin që është listuar në vendin e dytë. Në rast te tenderimit si grup i operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë dokumentet e lartcekura nën pikat 1,2,3 dhe 4. |
| **III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:** | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:* |
| **Operator Ekonomik duhet të jetë i regjistruar në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në vendin e themelimit të operatorit ekonomik. Shënim Në qoftë se kompania fituese e tenderit është e regjistruar jashtë Kosovës, para nënshkrimit të kontratës duhet të regjistrojë përfaqësinë e saj në institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës.** | **Kopja e çertifikatës të regjistrimit të biznesit.** |
| **Operatori Ekonomik duhet të jetë i regjistruar si deklarues i TVSH-së (vetëm për kompanitë vendore).** | **Kopja e çertifikatës së TVSH-së.** |
| **OE duhet të dëshmojë se është i certifikuar në lëminë e ndërtimit të ulët ISO Standard 9001 2015, ISO 14001 2015, ISO 45001 2015, EN ISO 39001 2012** | **Kopjet e certifikatave (valide)** |
| **III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:** | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:* |
| **Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit fiskale ka qenë prej jo më pak se 1,500.000.00 Euro** | **Deklaratat e dorëzuara ne Administratën Tatimore te Kosovës apo Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve te menaxhimit te certifikuara nga një kompani e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur** |
| **Kapital të mjaftueshëm për realizimin e kontratës (Mjete të gatshme në xhirollogari nga kompania në bankë në vlerë prej së paku 500,000,00 ose qasje në kredi të pa kushtezuar, nga një bankë duke emërtuar projektin për të cilin lejohet kredia.** | **Deklaratë nga banka që dëshmon se OE ka mjete të gatshme në xhirollogari ose qasje në kredi te pakushtezuar, dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni.** |
| **III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:** | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:* |
| **Lista e kontratave të realizuara, përfunduara në lëminë e kërkuar për periudhën e shkuar tre vjeçare jo më pak se 1.100.000,00. Operatori ekonomik duhet të ketë projekte të realizuara në lëmin e ndërtimit tç rrugëve, rehabilitimi ose mirëmbajtje të rrugëve. Në rast të formimit të grupit (konsorciumit), udhëheqësi i grupit duhet të ketë së paku 51% të shumës së kërkuar.** | **Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve.** |

| | |
|---|---|
| **Operatori ekonomik duhet të angazhoj personelin profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore të mëposhtme. a) Një menaxher i projektit-Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë- i licencuar, min. 3 vite përvojë pune pas diplomimit. Të ketë dëshmi se ka menaxhuar projekte nga lëmia e ndërtimi i rrugëve, rehabilitimi ose mirëmbajtje të rrugëve. b) Një udhëheqës i punishtes -Inxhinier i dip. i ndërtimtarisë – Drejtimi Konstruktiv ose infrastrukture rrugore - i licencuar, së paku 3 vite përvojë pune pas diplomimit , si udhëheqës i punishtes në projektet e ndërtimit të rrugëve, rehabilitim ose mirëmbajtje të rrugëve. c) Inxhinier i diplomuar i Hidroteknikes - i licencuar, me së paku 4 vite përvojë pune, i certifikuar si ekspert për siguri dhe shendet në punë, si dhe LED AUDITOR. d) Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë i licencuar, me së paku 3 vite përvojë pune pas diplomimit, ing. i gjodezisë (shkolla e lartë e gjodezisë), me së paku 3 vite përvojë pune pas diplomimit ose Bachelor i diplomuar i gjodezisë me së paku 5 vite përvojë pune pas diplomimit, provoja në projekte të realizuara në lëminë e kërkuar ndërtimi i rrugëve, rehabilitimi ose mirëmbajtje të rrugëve. e) Inxhinier i diplomuar i komunikacionit i licencuar, me së paku 3 vite përvojë pune pas diplomimit. Të ketë dëshmi se ka punuar projekte nga lëmia e kërkuar ndërtimi i rrugëve, rehabilitimi ose mirëmbajtje të rrugëve f) Një teknikë të dip. të ndërtimtarisë, me së paku 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Të ketë dëshmi se ka punuar projekte nga lëmia e kërkuar ndërtimi i rrugëve, rehabilitimi ose mirëmbajtje të rrugëve g) Një teknikë të dip. të arkitekturës me së paku 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Të ketë dëshmi se ka punuar projekte nga lëmia e kërkuar ndërtimi i rrugëve, rehabilitimi ose mirëmbajtje të rrugëve i trajnuar per siguri dhe shendet ne pune. h) Një- Inxhinier i sigurimit dhe kontrollit të cilësisë – me diplomë ne drejtime inxhinierike të nivelit master. me së paku 5 vite përvoje të punës në projekte të ngjashme, duke përfshirë tre (3) vite përvojë specifike si Menaxher Inxhinier i sigurimit dhe kontrollit të Cilësisë në projekte të ndërtimit të rrugëve, rehabilitimi ose mirëmbajtje të rrugëve i) Një- Specialist i shëndetit dhe sigurisë në punë - me diplomë në drejtime inxhinierike të nivelit bachelor i certifikuar për shëndet dhe siguri në punë. Me së paku 5 vite përvojë pune në projekte të ngjashme, duke përfshirë jo më pak se tre (3) vite përvojë specifike si specialist i shëndetit dhe sigurisë në punë në projekte të ndërtimit të rrugëve, rehabilitimi ose mirëmbajtje të rrugëve j) Një ekspert i instalimeve te tubacioneve për** | **Lista e stafit profesional dhe e punëtorëve duhet të dorëzohet në origjinal e nënshkruar dhe vulosur nga OE. Vendimi me shkrim mbi caktimin e menaxherit të projektit dhe udhëheqësit të jetë vulosur dhe nënshkruar nga të dyja palët. Për stafin nga pika a deri g OE të ofroj dëshmi CV-në e nënshkruar nga kandidati ku jane te cekura te gjitha projektet nga lemia e kerkuar , kopjen e diplomës universitare, kontrata valide kopje ose marrëveshje për angazhim në këtë projekt me punëdhënësin, si dhe referenca ne harmoni me projektet e cekura ne cv nga lemia e e ndërtimi i rrugëve, rehabilitimi ose mirëmbajtje të rrugëve. AK rezervon të drejtën që me rastin e zgjedhjes së fituesit nëse e sheh të nevojshme të kërkojë verifikimin e të gjitha dokumenteve të kërkuara. Për stafin nga pika h deri k OE të ofroj dëshmin e diplomës përkatëse dhe çertifikatës (kopje). -Për të dëshmuar pervojën e punës duhet të prezentoj CV-në e nënshkruar nga kandidati, kontrata valide kopje ose marrëveshje për angazhim në këtë projekt me punëdhënësin, si dhe referencat nga lemia e ndërtimi i rrugëve, rehabilitimi ose mirëmbajtje të rrugëve.<br>AK rezervon të drejtën që me rastin e zgjedhjes së fituesit nëse e sheh të nevojshme të kërkojë verifikimin e të gjitha dokumenteve të kërkuara.** |

| | |
|---|---|
| sistemet e ujisjellsit-i certifikuar. k) Një (1)Ekspert për mbrojtje nga zjarri i certifikuar nga AMF. | |
| OE duhet te jete i licencuar, leje per aktivitete te veqanta për bazë te asfaltit dhe si gurëthyes zhavori | Kopja e licences lejes per aktivitete te veqanta të vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale. Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon licencën, duhet ofruar Marrëveshjen për furnizim me OE te licencuar. Bashkangjitur duhet te jete Licencat e OE valide. |
| Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete dhe pajisjet teknike në gjendje të rregullt teknike për operim që janë te domosdoshme dhe të obligueshme për realizimin e projektit sipas Aneksit 7 (në rast të ofertimit si konsorcium, lideri duhet të përmbush së paku 51% të kërkesës). OE është i obliguar që pajisjet e prezentuara në listën e pajisjeve ti ketë në selinë e vet (një vend- seli), brenda në Kosovë, ku Autoriteti Kontraktues, komisioni i vlerësimit e bënë verifikimin e pajisjeve të prezantuara në listën e pajisjeve. OE 48 orë më herët njoftohet zyrtarisht lidhur me vizitën në teren nga ana e komisionit. | Dëshmitë për pronësi, posedim dhe shfrytëzim të mjeteve dhe pajisjeve teknike Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqes dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion (në pronësi ose me qera) operatorit ekonomik, që janë të domosdoshme për realizimin e projektit, si në vijim •Listën për mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë në dispozicion të operatorit ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punëve të projektit, sipas listës të bashkëngjitur në Aneksin 7 të DT.;për mjetet pajisjet që regjistrohen 1-16 duhet të dëshmohen me paraqitjen e Çertifikatës së regjistrimit të automjetit me afat valid të regjistrimit, që ndërlidhet me rastin e afatit të fundit të dorëzimit të ofertave, ndersa nga 11-20 deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes. Per mjete pajisje te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata ose marrëveshja për marrjen me qera të pajisjeve në emër të këtij aktiviteti, e cila duhet te jete e vlefshme per te gjithe periudhen deri ne perfundimin e plote te punimeve. |

## III.3) KUSHTET SPECIFIKE PËR KONTRATAT E SHËRBIMEVE

Po ☐ Jo ☐

**III.3.1)Ekzekutimi i shërbimeve i rezervuar për një profesion të caktuar**

*Nëse po,* referenca për ligjin, rregulloren apo dispozitën administrative përkatëse

**III.3.2 Personat ligjor duhet të tregojnë emrat e kualifikimeve profesionale të personelit përgjegjës për ekzekutimin e shërbimeve**

Po ☐ Jo ☐

## NENI IV: PROCEDURA

## IV.1) LLOJI I PROCEDURËS

| IV.1.1) Lloji i procedurës |
|---|
| ☒ E hapur |
| ☐ E kufizuar |

☐ **Konkurruese me negociata**

☐ **Kuotim i Çmimit**

**IV.1.2)Kufizime në numrin e operatorëve të cilët do të ftohen për tenderim** *(procedurë e kufizuar apo konkurruese me negociata)*

Në bazë të aplikacioneve të pranuara, më së shumti 6 kandidat do të ftohen për të dorëzuar tenderët e detajuar të kësaj kontrate. Nëse më shumë se 6 kandidat të përshtatshëm i plotësojnë kriteret e mësipërme të përzgjedhjes, përparësitë dhe dobësitë relevante të aplikacioneve të këtyre kandidatëve do të ri-ekzaminohen për të identifikuar gjashtë aplikacionet më të mira për proceduren e tenderit. Të vetmit faktorë të cilët do të mirren parasysh gjatë këtij ri-ekzaminimi janë:

**IV.1.3) Reduktimi i numrit të operatorëve gjatë negociatave** *(procedurë konkurruese me negociata)*

Udhëheq negociatat në faza të njëpasnjëshme

**Po** ☐ **Jo** ☐

në mënyrë që të zvogëlohet numri i tenderëve të negociuar

Autoritetet kontraktuese mund të shpërblejnë
kontratat në bazë të tenderëve fillestarë pa negociata

**Po** ☐ **Jo** ☐

**IV.1.4 Numri minimal i kandidateve te cilët do te ftohen qe te dorëzojnë Tenderët fillestar është:**

**IV.1.5. Informata ne lidhje me ankandin elektronik**

Do te përdoret ankandi elektronik: Po ☐ Jo ☒

Informata shtese ne lidhje me ankandin elektronik:

## IV.2) KRITERET E DHËNIES

☒ **Çmimi më i ulët**

*ose*

☐ **Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të**

## IV.3) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

**IV.3.1) Publikimet paraprake në lidhje me kontratën e njëjtë**

**Po** ☐ **Jo** ☒

***Nëse po,***

Njoftim paraprak: i

Publikime tjera (*nëse aplikohen):*
i

| |
|---|
| i |
| **Po** ☐ **Jo** ☒<br>Dokumentet me pages<br><br>***Nëse po**,* çmimi EUR<br>Kushtet dhe metoda e pagesës: |
| **IV.3.2) Afati i fundit për pranim të *tenderëve / aplikacioneve:***<br><br>***data* 20.10.2025 *koha* 14:00:00 *vendi* E-Prokurimi** |
| **IV.3.3) Afati kohor për dorëzimin e *tenderëve / aplikacioneve* është shkurtuar:**<br>☐ **Po** ☒ **Jo**<br><br>***Nëse po**,* jep arsyetim |
| **IV.3.4)** A është e nevojshme siguria e tenderit:<br>**Po** ☒ **Jo** ☐<br><br>***Nëse po***, vlera e sigurisë së tenderit **23,000.00euro**<br>Vlefshmëria e sigurisë së tenderit në ditë **120** *apo* muaj |
| **IV.3.5) Periudha e vlefshmërisë së tenderit:**<br>Deri më: data: ditët **90** apo muajt |
| **IV.3.6) Takimi për hapjen e tenderëve:**<br><br>**data 20.10.2025 koha 14:00:00 vendi zyra e prokurimit, nr, 55, kati II, objekti i ri i komunës** |

## NENI V: INFORMACIONET PLOTËSUESE

### V.1) ANKESAT

| |
|---|
| **Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092ne adresën e specifikuar ne Nenin I te këtij Njoftimi për kontratë.** |

### V.2) INFORMACIONET SHTESË

| |
|---|
| **Shënim: operatorët ekonomik do të kenë të drejtë të dorëzojnë tenderin, kërkesën për pjesëmarrje dhe dokumentet e tjera të nevojshme apo dosjet të cilat u lejohen gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze.**<br>*Shto informacione tjera: (si konferenca para-ofertuese, vizita ne punishte etj)* |